



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.06.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Arhiko.ing OP" për aktivitetin: "Ndërtimi i mureve rezistuese ndaj rreshqitjes së dheut, vershimeve" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-1497-521 nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "ARHIKO.ING OP" e datës 31.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i mureve rezistuese ndaj rreshqitjes së dheut, vershimeve" dhe me Nr. 616 1497 521, Nr. Brendshëm 616 19 048 521 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së të datës 27.05.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 27.05.2019;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "ARHIKO.ING OP" me datë 31.05.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i mureve rezistuese ndaj rreshqitjes së dheut, vershimeve" me Nr. 616 19 1497 511 Nr. Brendshëm 616 19 048 521". Autoriteti Kontraktues, me datë 03.06.2019 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi i pare është i pa bazuar pasi që AK-ja ka shqyrtuar me kujdes sqarimet e ofruara, por të njëjtat nuk janë në harmoni me kërkesat e AK-së dhe me dispozitat ligjore, pasi që në asnjë rast nuk është paraqitur asnjë analizë e asnjë elementi të çmimit për materialet e kerkuara, por ka vetëm deklarime të pa argumentuara. Ndoshta kjo ka ndodhur për faktin se me analizë të çmimeve është pamundur të argumentohet çmimi i dhënë që përfaqëson 1/3 e çmimit të tregut. Pasi që gjatë shqyrtimit të kërkesës tuaj kemi vërejtur edhe një çmim manipulues: çmimin e armatures prej 4.95 euro për kilogram që është se paku gjashtëfish mbi çmimin e tregut dhe kjo është ben edhe me joserioz dhe me të pa përgjegjshëm tenderin tuaj.

Pretendimi dyte i ankuesit se formulari i tenderit nuk eshte i nenshkruar ne formen elektronike(eshte fjala per tenderin e tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates)eshte i pa bazuar pasi qe me RRUOPP eshte rregulluar si vijon: Neni 39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik. **Nënskrimi digjital nuk është i obligueshem deri ne njoftim zyrtar nga KRPP.**

Pretendimi tjetër se AK-ja ka shpallur fitues nje tenderues me çertifikata te vjetra eshte plotesisht i pa bazuar pasi qe nje kerkese e tille nuk ekziston ne dosjen e tenderit dhe AK-ja nuk ka pranuar asnje deri me tash ndonje njoftim zyrtar nga asnje Institucion lidhur me kete.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne të gjitha konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit